



SPACHTEL ELASTICH

Stuko patinimi me bazë akrilike, e përbërë nga filler me granulometri të seleksionuar dhe aditivë specialë për riparimin e plasaritjeve në mure dhe tavane. Përdoret për riparim në ambientet e brendshme dhe të jashtme

Karakteristikat e produktit

- Nuk krijon çarje
- Ngjitje e fortë
- Elasticitet i mirë
- Ngjyrë e bardhë
- Aplikim dhe zmerilim i lehtë
- Mbulueshmëri shumë e mirë
- Nuk ka tkurrje edhe me cipë të trashë

Rekomandimet për përdorim

Përdoret për lëmimin e mureve në të gjithë ambientet e brendshme të banimit, ku duam të krijojmë sipërfaqe të lëmuar dhe të drejtë, për riparimin e plasaritjeve dhe sipërfaqeve të dëmtuara në ambiente të brendshme si dhoma, kuzhina, tualete, etj. Përdoret për riparimin e plasaritjeve dhe sipërfaqeve të dëmtuara në ambiente të jashtme si fasada, etj.

Instruksione Aplikimi

- Përgatitja e sipërfaqes

Sipërfaqet duhet të jenë të thara plotësisht, të pastra dhe pa elemente që pengojnë ngjitshmërinë e produktit. Sipërfaqja që do të mbushet flimisht hapet në mënyrë që të bëhet mbushje sa më e plotë.

Përgatitja e produktit

Produkti është i gatshëm për aplikim. Rekomandohet të bëhet një homogjenizim i produktit duke u përzier me një mikser elektrik para përdorimit.

Aplikimi i produktit

Aplikimi i produktit Spachtel Elastich bëhet me anën e një malle metalike. Produkti hapet mbi sipërfaqen që duam të patinojmë dhe drejtohet deri në spesorin e nevojshëm.

Spesori i aplikimit për një shtresë nuk duhet të kalojë 3 mm. Produkti aplikohet me disa shtresa deri sa të arrihet sipërfaqja e dëshiruar. Pastroni spatulat dhe mjetet e tjera të punës me ujë menjëherë pas aplikimit.

Të dhëna teknike

Baza	Kopolimer akrilik
Densiteti EN ISO 2811-1	1,75±0,02 gr/ml
Mbetja e thatë EN ISO 3251	70%
Raporti i përzierjes	Gati për përdorim
Ngjyra	E bardhë
Forca ngjitëse në beton	≥ 0,8 N/mm ²
Konsumi	1 Kg/m ²
Koha e tharjes mes dy shtresave	2 – 4 orë
Koha e tharjes për zmerilim	24 orë
Koha e tharjes për lysterje	72 orë
Rezistenca në ngjeshje	≥ 800 N

Ruajtja

24 muaj nëse ruhet në një vend të thatë, larg burimeve të nxehtësisë, në një temperaturë midis +5°C dhe +30°C. Mbrojeni nga ngrica.

Shënime

- Në sipërfaqet e freskëta të betonit produkti rekomandohet të aplikohet të paktën pas 30-40 ditësh.
- Rekomandohet të shmangni aplikimin e produktit në temperatura nën 5°C.

